

REZOLUTË

PËR RAPORTIN VJETOR TË KËSHILLIT KOMBËTAR TË RADIOS DHE TË TELEVISIONIT PËR VITIN 2005

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë:

- duke njohur rolin e KKRT-së si enti i vetëm rregullator në fushën e transmetimeve radio e televizione dhe autoriteti kryesor i zbatimit të legjislacionit shqiptar në këtë fushë;
- duke vlerësuar se veprimtaria njëvjeçare e KKRT-së është në vazhdim të përpjekjeve për rregullimin ligjor të veprimtarisë së mediave, veprimtari kjo e nisur që me krijimin e këtij institucioni;
- duke qenë i ndërgjegjshëm se fillimi i veprimtarisë së këtij autoriteti, ashtu si edhe i ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, u krye në kushtet e ekzistencës së shumë operatorëve në treg dhe të një situate kaotike në zhvillimin e mediave elektronike;

- duke çmuar si jashtëzakonisht të dobishëm bashkëpunimin e KKRT-së dhe mbështetjen e tij në ekspertizën dhe ndihmën e ofruar nga institucionet ndërkombëtare, si dhe arritjet e realizuara në këtë fushë;

Konstaton se:

- është bërë një hap i pamjaftueshëm në rregullimin e veprimtarisë radio e televizione në Republikën e Shqipërisë;

- operatorët radio e televizionë ende nuk e njohin rolin dhe autoritetin e KKRT-së dhe, në përgjithësi, respektimin e detyrimeve ligjore dhe zbatimin e kushteve të licencimit;

- KKRT-ja është nënshtruar ndaj presioneve të ardhura nga grupet e ndryshme të interesit apo nga politika;

- KKRT-ja ka pësuar një dështim të plotë ndaj zbatimit të të drejtave të transmetimit dhe të rregullave të konkurrencës, sidomos pas daljes në emetim të operatorëve pa licencë;

- KKRT-ja është gjetur e paafte dhe e papërgatitur të veprojë në zbatim të ligjit për të parandaluar shkelësit e tij;

- respektimi i të drejtave të transmetimit dhe i zonave të licencuara të mbulimit vazhdon të mos njihet dhe të mos respektohet qartë nga operatorët.

Duke njohur rëndësinë e zbatimit dhe më tej përmirësimit të legjislacionit në fushën e veprimtarive radio e televizione, si dhe rolin përcaktues të KKRT-së në këtë fushë,

Kuvendi kërkon:

1. Shkarkimin e anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit si përgjegjës kryesor për moszbatimin e ligjit “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

2. Vendosjen e autoritetit të zbatimit të ligjit në mënyrë të plotë.

3. Reformimin institucional të KKRT-së për ta riorganizuar këtë institucion në mënyrë më funksionale.

Tiranë, më 27.2.2006